

# BULETINI MUJOR

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

[www.ild.al](http://www.ild.al) | [info@ild.al](mailto:info@ild.al)



Inspektori i Lartë i  
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani  
@ILD\_Albania

**NJË MEKANIZËM MBIKQYRJE NGA KUVENDI,  
I NEVOJSHËM PËR MATJEN E PERFORMANCËS SË  
INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË**





## NJË MEKANIZËM MBIQYRJE NGA KUVENDI, I NEVOJSHËM PËR MATJEN E PERFORMANCËS SË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani paraqiti para deputetëve të kuvendit punën e bërë nga institucioni gjatë vitit 2022.

Në fjalën e tij, z. Metani e ka vënë theksin edhe tek kontributi si institucion tek sistemi i drejtësisë.

“Viti 2022 ka qenë një vit, përgjatë të cilit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka ushtruar gjerësisht kompetencat e tij për të rritur efikasitetin e rolit të tij dhe rrjedhimisht dhe atë të pushtetit gjyqësor.

Standardet e vendosura gjatë procesit të trajtimit të ankesave, të zhvillimit të hetimeve dhe procedimeve disiplinore; kryerja e inspektimeve tematike; rritja e bashkëpunimit

ndërkombëtar në fushën e inspektimit gjyqësor; organizimi i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbim përvojash në inspektimin gjyqësor, janë disa nga gurët solidë të themelit, në këndvështrimin tim, të punës që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po ngre duke patur parasysh një zgjidhje afatgjatë të problematikave të sistemit të drejtësisë dhe jo duke u fokusuar në problematika apo interesa të çastit.”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve, por edhe angazhimin e të gjithëve për zbatimin e saj, si një kontribut për gjithë shoqërinë.

“Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve





periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë.

Në këtë kuadër, ILD gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.

Nga ana tjetër, kjo kërkon një proces konsultues të koordinuar dhe aplikimin e një qasje më të gjerë koordinimi apo mekanizëm mbikëqyrje, analize dhe hartimi plani veprimi për secilin institucion në nivel sistemik dhe strategjik.” tha z. Metani.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

RAPORT PËR PUNËN GIATË VITIT 2022



PËR PUNËN E ZYRËS SË  
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PËR PERIUDHËN  
01.01.2022 – 31.12.2022



## FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË GJATË RAPORTIMIT VJETOR NË KUVEND

*E nderuar kryetare e Kuvendit,*

*Të nderuar deputetë,*

Për sa vërehet nga raporti i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022, rezulton se institucioni që drejtoj ka patur një vit shumë dinamik, si në drejtim të verifikimit të ankesave ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, hetimit disiplinor e inspektimeve tematike, të cilat i kemi patur në fokus, edhe në raport me rekomandimet e rezolutës së miratuara nga ana Kuvendit për vitin e kaluar, por edhe bashkëpunimin me institucione apo organizata brenda dhe jashtë vendit.

Duke shmangur një retorikë të mbështetur në shifra apo analizë, pasi ato janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në raport, sot nëpërmjet këtij procesi raportimi do të doja të shfrytëzoja këtë mundësi, për të komunikuar me ju, jo vetëm mbi disa çështje, që besoj shumë se kanë

qenë një pikë e fortë e veprimtarisë së ILD-së gjatë vitit të shkuar, por edhe mbi disa refleksione, që mund dhe duhet të gjejnë zgjidhje në të ardhmen.

Gjatë vitit 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar punën me trajtimin e praktikave dokumentare apo të ankesave të trashëguara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim uljen e *backlogut* të krijuar si pasojë e periudhës kalimtare të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë. Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar edhe ankesat e reja të cilat janë depozituar pranë Zyrës së ILD-së si nga ana e qytetarëve ashtu edhe nga ana e institucioneve publike.

Trajtimi i këtyre praktikave (*praktikat dokumentare pjesë të backlogut si dhe ankesat e reja*) është realizuar në përputhje me një metodologji të bazuar në parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe efikasitetit. Aplikimi i kësaj metodologjie ka pasur si qëllim si shmangien e kulturës së

harresës dhe të pandëshkueshmërisë të magjistratët në lidhje me ankesat e vjetra të dorëzuara nga ana e qytetarëve pranë institucioneve të mëparshme, ashtu edhe plotësimin e pritshmërive të tyre në raport me ankesat e reja të paraqitura.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar unifikimit të akteve të hartuara nga ILD si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Synimi kryesor ka qenë dhe mbetet aplikimi i standardeve të njëjta dhe transparente si në kuadër të verifikimit të ankesave apo pretendimeve të bëra publike, ashtu edhe gjatë zhvillimit të procedurave të hetimit disiplinor ndaj magjistratëve. ILD ka pasur si synim, gjithashtu, të promovojë praktikën më të mira në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit. Në mungesë të një praktike të konsoliduar administrative si dhe gjyqësore, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka luajtur një rol të rëndësishëm lidhur me interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të ri mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.

Në të njëjtën kohë, ILD gjatë vitit 2022 ka pasur si synim ushtrimin në mënyrë sa më të plotë dhe profesionale të kompetencave të veta me qëllim krijimin e një sistemi drejtësie llogaridhënës, funksional e të mbështetur jo vetëm në standardet e përgjegjshmërisë apo përgjegjësisë, por edhe atë të pavarësisë. Ky është një proces shumë delikat, me rëndësi dhe nuk ka qenë i lehtë, pasi sistemi i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së magjistratëve duhet të funksionojë duke

ruajtur një ekuilibër të drejtë apo balancë ndërmjet interesit të publikut për t'u njohur me administrimin e drejtësisë nga gjyqtarët dhe prokurorët dhe pavarësisë së këtyre magjistratëve.

Sistemi i përgjegjshmërisë apo ai disiplinor duhet të luajë pikë së pari një *rol parandalues* nëpërmjet identifikimit të çdo problematike në funksionimin ose jo të sistemit të drejtësisë, si dhe miratimin e rekomandimeve për përmirësimin e tyre. Ky sistem kontrolli nuk duhet të shërbejë asnjëherë si një mjet presioni mbi veprimtarinë e punës së magjistratëve, por si një mjet i rëndësishëm për të matur eficiencën dhe cilësinë e veprimtarisë së punës së tyre, profesionalizmin apo të ndihmojë në rritjen e cilësisë së vendimmarrjes së magjistratëve.

Në kuadër të kësaj fryme është ushtruar edhe veprimtaria e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Krahas trajtimit të rasteve individuale, nëpërmjet zhvillimit të procedimeve disiplinore, të cilat janë aplikuar vetëm në raste të veçanta dhe *si mjete të jashtëzakonshme* lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, një vëmendje e shtuar i është kushtuar edhe qasjes parandaluese dhe rolit ndihmës që ILD mund të luajë për të ngritur kapacitetet e pushtetit gjyqësor. Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2022 i ka kushtuar një rëndësi të veçantë zhvillimit të inspektimeve tematike dhe planifikimit të tyre. Ky proces inspektimesh tematike dhe institucionale po vijon edhe gjatë këtij viti. Ky

**Sistemi i përgjegjshmërisë apo ai disiplinor duhet të luajë pikë së pari një rol parandalues nëpërmjet identifikimit të çdo problematike në funksionimin ose jo të sistemit të drejtësisë, si dhe miratimin e rekomandimeve për përmirësimin e tyre.**

Standardet e vendosura gjatë procesit të trajtimit të ankesave, të zhvillimit të hetimeve dhe procedimeve disiplinore; kryerja e inspektimeve tematike; rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e inspektimit gjyqësor; organizimi i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbim përvojash në inspektimin gjyqësor, janë disa nga gurët solidë të themelit, në këndvështrimin tim, të punës që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po ngre duke patur parasysh një zgjidhje afatgjatë të problematikave të sistemit të drejtësisë dhe jo duke u fokusuar në problematika apo interesa të çastit.

Për të arritur në qëllimin për të cilin u konceptua dhe u miratua reforma në drejtësi, për të arritur që të jetojmë me vlerat e kushtetutshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, të gjithë ne duhet të bashkëpunojmë. Padyshim, e them këtë jo vetëm në kuptimin e gjerë të fjalës, të kultivimit të së drejtës si një vlerë shoqërore dhe politike, të kultivimit të së drejtës si standard dhe jo statistikë. Por, në një kuptim më të ngushtë, të gjithë ne duhet të analizojmë dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë.

Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë. Në këtë kuadër, ILD gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Nga ana tjetër, kjo kërkon një proces konsultues të koordinuar dhe aplikimin e një qasje më të gjerë koordinimi apo mekanizëm mbikëqyrje, analize dhe hartimi plani veprimi për secilin institucion në nivel sistematik dhe strategjik.

Gjatë vitit 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar të mbajë si prioritet të qëndrueshëm trans-

parencën me publikun, përmes një ndërveprimi me qytetarët, si përmes pasurimit informativ të faqes së internetit të ILD-së ashtu edhe angazhimit të Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave. ILD në kuadër të vlerësimit të informacionit të bërë publik në media, denoncimeve të bëra nga publiku apo edhe të dhënave të siguruara gjatë ushtrimit të funksionimit, ka luajtur një *rol proaktiv* për sa i përket vlerësimit dhe trajtimit të rasteve ku është pretenduar për shkelje të mundshme disiplinore të kryera nga magjistratët.

Gjatë vitit 2022 ILD ka pasur si synim gjithashtu përdorimin e teknologjisë së informacionit për të lehtësuar procesin e trajtimit të praktikave dokumentare si dhe veprimtarinë e punës së Zyrës së ILD-së. Përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve jomagjistratë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe rritjen mëtejshme e kapaciteteve profesionale të inspektorëve.

#### *Të nderuar deputetë,*

Së fundi, dua të theksoj, se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka qenë i vëmendshëm, ka studiuar dhe ka referuar, zgjidhur, plotësuar dhe vendosur në objektivat e veta për të ardhmen, çdo pikë të rezolutës, që ky organ ka besuar dhe ka zgjedhur të na e transmetojë, nëpërmjet një akti të miratuar në këtë sallë.

Sot pres me interes dhe jam i vëmendshëm ndaj çdo vendimmarrje tuajën, lidhur me ato, që ju i rekomandoni, si sfida të vitit që vjen. Por jo vetëm!

Ju siguroj që jam dhe do jem i vëmendshëm ndaj çdo diskutimi tuaj, të secilit prej jush, me qëllim që të mund të kuptoj edhe më shumë, përtej asaj që do të miratoni në rezolutën tuaj, si akt i këtij Kuvendi. Unë besoj, se secili prej jush, nëpërmjet fjalës së vet, apo qoftë edhe debatit mes jush, mund të kontribuojë që të na bëjë të kuptojmë, nëse ka çështje të tjera, që mund të na sillen në vëmendje.



Këto seanca ne Kuvend, i konsideroj domosdoshmëri, jo vetëm ligjore e kushtetuese, por mund dhe duhet të shërbejnë, si një hapësirë e madhe debati, një mundësi e vyer për ofrimin e tezave për përmirësimin e performancës së institucionit. Kjo pasi në këndvështrimin tim, zbatimi i reformës në drejtësi nuk është dhe nuk duhet të jetë një betejë vetëm e institucioneve të drejtësisë, por edhe e institucioneve të tjera, e më tej gjithë shoqërisë. Respektimi i parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve duhet të transmetohet tek qytetarët, si një vlerë themelore e shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike.

Ju faleminderit!

\*\*\*

**Deputetja znj. Albana Vokshi:** Pyetja e parë, strukturat e rivlerësimit kanë sjellë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë një numër të konsiderueshëm çështjesh për vlerësim, bazuar në verifikimet që kanë kryer ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga ana tjetër është vënë re një numër minimal çështjesh të raportuara si të përfunduara nga ana e Institucionit tuaj. Për cilat

arsye është kjo situatë proporcionale mes rasteve të referuara pranë jush dhe inspektimeve të përfunduara. Pyetja e dytë, Institucioni i Komisionerit Publik ka kërkuar pranë Kolegjit të Posaçëm të apelimit të nis veprim administrativ për mosveprim të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për rastin e një ish gjyqtareje të gjykatës së Lartë. Si është fryma e bashkëpunimit mes dy institucioneve, nëse ka përplasje mes dy institucioneve të reja të drejtësisë? A i shërben kjo interesit më të madh publik? Pyetja e tretë, aktiviteti i Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, ashtu edhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor, apo të ndonjë institucioni tjetër të krijuar pas reformës në drejtësi, karakterizohen shpesh herë nga mungesa e transparencës. Dua t'ju rikujtoj se të gjitha institucionet në fakt duhet të jenë në shërbim të publikut dhe ju pyes për standarde të ndryshme që ndiqen nga ana e institucionit tuaj. Në rastet e raportimeve mediatike për shkeljet e pretenduara nga gjyqtarë apo prokuror i publikoni nëse keni nisur verifikime dhe inspektime ndërsa në raste të tjera tregoheni më hermetik dhe nuk bëni publik asnjë rezultat konkret për këto inspektime. Pse ky trajtim i diferencuar, pse nuk bëhen publike, në fund të fundit e përsëris duhet ti shërbejnë publikut dhe institucionet duhet të jenë transparente. Pyetja e fundit, para



disa ditësh gjykata ka vendosur ndryshimin e masës së arrestit për ish ministrin Sajmir Tahiri, si e vlerësoni ju këtë vendim pse nuk bëhet publik raporti mjekësor për bashkëshorten i cili u mor në konsideratë për ndryshimin e dënimit në arrest shtëpiak. A ka nisur qoftë dhe kryesisht ILD-ja inspektim për këtë çështje? Nëse Gjykata e lartë e dënon për grup të strukturuar kriminal, çfarë ndodh me Sajmir Tahirin, sepse dënimi do të jetë më i rëndë, për pasojë edhe vendimi që e nxori nga qelia duhet të bjerë. Faleminderit.

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:** Faleminderit për pyetjet zonja Vokshi. Në lidhje me pyetjen e parë, sipas një informacioni që kam bërë në prill të vitit 2023, të dhënat janë 39 raste të referuara nga organet e rivlerësimit 27 raste të proceduara apo të trajtuara nga Inspektori i Lartë i drejtësisë.

Në lidhje me pyetjen e dytë për Komisionerin Publik. Fryma e bashkëpunimit ndërinstytucionale është korrekte dhe në përputhje me ligjin. Ajo që vërej është... padyshim që institucionet e reja janë ngritur dhe po zbatojnë një kuadër kushtetues dhe ligjor të ri edhe padyshim që zbatimi i këtyre nocioneve, instituteve apo koncepteve të reja do sjelli edhe debat nëpërmjet institucioneve, i takon në fakt organeve të rivlerësimit që të prodhojnë jurisprudencë, të prodhojnë mendim në lidhje me këto raporte apo këto debate dhe jo përplasje mes institucioneve. Pa dyshim ka debate juridike për këto çështje, unë e shoh si gjë pozitive që i shërben jo vetëm institucioneve, por tek e fundit dhe interesit publik, sa më shumë debate juridike të ketë nëpërmjet institucioneve, jo në media, aq më mirë është për zhvillimin e institucioneve dhe frymës e të cilën u miratua edhe reforma dhe vazhdon puna e institucioneve.

Në lidhje me pyetjen e tretë. Në fakt të them

të drejtën transparencën e konsideroj si pikë të fortë të ILD-së dhe për disa nga komentet do të kisha një mendim tjetër, por megjithatë për të qenë korrekt me ju dhe me pyetjen, çdo inspektim që është bërë nga ILD është sot në faqen e internetit që në momentin që është miratuar, inspektimet tematike flas. Çdo rast i nisur për shkak të raportimeve në media dhe që është proceduar nga këshillat padyshim është publik sepse seancat në këshill janë publike. Për çdo rast për të cilat ILD është shprehur se ka nisur verifikim, besoj këto duhet të jenë 4 ose 5, vetëm në një rast ILD nuk ka kthyer përgjigje për gjetjet e hetimeve apo verifikimeve të rastit, në të gjitha rastet kemi dhënë raport për çështjet si e kemi përfunduar në këtë rast ka qenë gabimi ynë me thënë të drejtën, por ka qenë një rast sporadik.

Në lidhje me pyetjen e fundit, atëherë Inspektori i Lartë i Drejtësisë së pari operon me ankesa, kjo është forma kryesore. Çdo qytetar, çdo institucion publik, çdokush që ka pretendime për sjellje të magjistratit në një mënyrë të caktuar në kundërshtim me ligjin mund ti bëjë ankesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe kjo është në këndvështrimin tim mënyra më e shëndetshme që i shërben sistemit, sepse vetëm kështu mund të kontrollohet edhe vendimmarrja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke ankimuar vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këshillat përkatës. Ka një mënyrë të dytë që e parashikon ligji, që në raste të veçanta ILD mund të vihet në lëvizje edhe kryesisht për shkak të njoftimeve në media, padyshim kjo s'mund të jetë pjesa kryesore e punës së ILD-së. ILD vihet në lëvizje për ato raste që ILD vlerëson se mund të përbëjë shkak apo material për punën e tij, kjo ishte pak a shumë mënyra sesi funksionon ILD. Në rastin konkret, nuk ka një inspektim të nisur nga ana e ILD, por nuk ka asnjë ankesë të paraqitur pranë ILD.





## KLP PRANON KËRKESËN E ILD-SË PËR SHKARKIMIN E PROKURORIT S.H.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore “shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit S.H., në kohën e shkëljes disiplinore, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkëljen e parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sipas raportit hetimor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magjistrati S.H. është gjetur fajtor nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kryerjen e veprës penale të “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, dhe “Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo per-

soni tjetër, që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe është dënuar me 2 vjet e 4 muaj burgim.

Nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, rezulton se janë ndërmarrë veprime të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe me qëllim përfitim të padrejtë prej saj, duke favorizuar një palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimit. Prokurori S.H. ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin e magjistratit dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

ILD konkludoi në hetimin e vet, se veprimet e magjistratit përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore dhe kërkoi nga Këshilli i Lartë Prokurorisë pranimin e kërkesës për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për prokurorin S.H., kërkesë që u miratua.



### *Gjatë asistimit të ankuesve*

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas

komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

***Gjatë muajit Korrik 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 14 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 15 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.***

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

## SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Korrik 2023**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **18 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

## ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- \* mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- \* të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- \* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.





## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË FINALIZON PLANIN E INTEGRITETIT TË INSTITUCIONIT

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me Qendrën Europiane, të mbështetur nga Komiteti i Helsinkit, ka hartuar Planin e Integritetit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2023-2024.

Draft-dokumenti u diskutua gjatë një takimi pune me ekipin e zyrës së ILD-së, ku sekretarja e përgjithshme e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë znj. Dëshira Pasko evidentoi se Plani i Integritetit do të shërbejë si një dokument i







brendshëm me karakter udhëzues, në të cilin janë brendshme të ILD-së. Njëkohësisht përmirësimi i performancës, rritja e integritetit, që do të udhëheqin punonjësit e zyrës së ILD-së, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në profesionalizmi në ushtrimin e detyrave, përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi të kontribuojnë në përmirësimin e imazhit të institucioneve të cilin dhe rrjedhimisht, në rritjen e besimit të



qytetarëve ndaj institucionit dhe sistemit të drejtësisë. “, tha mes të tjerash znj. Pasko.

Pas prezantimit të Planit të Integritetit nga ekspertja ligjore znj. Eda Nocka, diskutimet u fokusuan tek objektivat dhe masat e këtij plani, që i shërben institucionit për identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve, që çenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

“Kjo është një nismë e përbashkët mes Qendrës Europiane dhe ILD-së, mbështetur nga Komiteti i Helsinkit përmes fondeve të qeverisë Suedeze, e cila vjen si produkt i parë në kuadër të një

Marrëveshjeje Mirëkuptimi nënshkruar mes ILD dhe 6 organizatave të shoqërisë civile në Mars të vitit 2022.”, tha në fjalën e saj drejtorja ekzekutive e Qendrës Europiane znj. Ina Xhepa.

Në emër të Komitetit të Helsinkit, znj. Servete Ceka vlerësoi në fjalën e saj bashkëpunimin shumë të mirë deri tani me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, edhe me mbështetjen për hartimin e Planit të Integritetit në kuadër të projektit “Përmirësimi i performancës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si një institucion kyç për një gjyqësor profesional në Shqipëri.”

Pas reflektimit të sugjerimeve të bëra gjatë diskutimeve në këtë takim pune, plani do miratohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.







### INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI DELEGACIONIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË SË MALIT TË ZI

Me ftesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Artur Metani, një delegacion i Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Malit të Zi zhvilloi një vizitë zjrtare në Tiranë. Z. Metani shprehu kënaqësinë që komunikimi i nisur gjatë vizitës së tij në Podgorice vijon në Tiranë, si një mundësi konkrete për të vijuar me shkëmbimin e përvojës, në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit, përgjegjshmërinë e llogaridhënien e magistratëve, profesionalizmin dhe inkurajimin e praktikave më të mira të punës.

“Konsolidimi i shtetit të së drejtës për një demokraci funksionale mbetet një sfidë për të dy vendet, edhe në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian”, – tha mes të tjerash z. Metani,- dhe “komunikimi dhe bashkëpunimi në fushën e drejtësisë mes vendeve të rajonit duhet të zhvillohet edhe përmes tryezave më të gjera se ato dypalëshe.”



## ILD në Twitter

← Inspektori i Larte i Drejtesise Ar... **Follow**  
468 Tweets



Inspektori i Larte i Drejtesis... @ILD... · Jul 25 ...

Glad to welcome today Dr. Judithanne Scourfield McLauchlan in the institution of #HIJ. We had an insightful discussion about rule of law, civic education and democracy in 🇷🇸 and 🇺🇸



🗨️ ↻️ 2 ❤️ 6 📊 234 ↗️

← Inspektori i Larte i Drejtesise Ar... **Follow**  
468 Tweets



Inspektori i Larte i Drejtesis... @ILD... · Jul 21 ...

Momente pune në #ILD 📍: pritja e qytetarëve nga zyra jonë e ankesave dhe e marrëdhënieve me publikun cdo ditë nga ora 09.00-14.00.  
[#përkushtim](#) [#përgjegjshmëri](#)



🗨️ ↻️ 1 ❤️ 4 📊 220 ↗️

Z. Metani zhvilloi një takim me znj. Judithanne Scourfield McLauchlan, pedagoge e shkencave politike në Universitetin e Floridas. E diplomuar dhe me eksperiencë në fushën e drejtësisë, ajo është drejtore themeluese e Qendrës për Edukim Qytetar.

Z. Metani postoi në Tëitter pas takimit: “I lumtur të mikprisja sot në institucionin e ILD, Dr. Judithanne Scourfield McLauchlan. Patëm një diskutim të thelluar mbi sundimin e ligjit, edukimin qytetar dhe demokracinë në Shqipëri dhe SHBA.

#### ZYRA E ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Momente pune në #ILD: pritja e qytetarëve nga zyra jonë e ankesave dhe e marrëdhënieve me publikun çdo ditë nga ora 09.00-14.00.

[#përkushtim](#) [#përgjegjshmëri](#)

## KORRIKU NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Korrik** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **71 ankesa**, të paraqitura nga qytetarë dhe 1 (një) ankesë e paraqitur nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Korrik 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

## VERIFIKIME

57 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ 44 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);
- ⇒ 13 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

## HETIME DISIPLINORE

1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat

5 vendime për përfundim hetimi disiplinor për 11 magjistratë

## ARKIVIME


267 vendime arkivimi nga 400 praktika të shqyrtuara konkretisht :

- ◆ 155 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD, nga të cilat
  - ⇒ 134 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
  - ⇒ 21 vendime arkivimi pas verifikimit
- ◆ 112 vendime arkivimi nga praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):
  - ⇒ 76 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
  - ⇒ 36 vendime arkivimi pas verifikimit



## SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Korrik** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **10 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë **277 shpallje publike**.



### INFORMACION

*Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit).*

*Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.*

*Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.*

**KORRIK 2023**

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD

**KONTAKT ILD**

**WEB:** [ild.al](http://ild.al)

**EMAIL:** [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

**ADRESA:** Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD*